




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



KGJK.nr.99/2024
Datë: 11 prill 2024

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 i Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nenit 2, paragrafi 1, pika 1.5, Rregullores Nr. 08/2017 për praktikantë në Gjykata dhe Sekretariatit e KGJK-së, si dhe nenit 14, paragrafit 2, pika 2.1 dhe 2.6 të Ligjit Nr.06/L-054 për Gjykatat, në takimin e 324-të, të mbajtur me datë 11 prill 2024, merr këtë:

V E N D I M

- I. Autorizohen kryetarët e gjykatave, që të nënshkruajnë marrëveshje me institucionet e arsimit lidhur me angazhimin e studentëve për punë praktike në gjykatat e Republikës së Kosovës.
- II. Kryetarët e gjykatave të vlerësojnë nevojën dhe kapacitetet e gjykatës sa i përket sistemimit të studentëve në punë praktike.
- III. Vendimi hyn në fuqi me datë 11 prill 2024.

A r s y e t i m

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, në takimin e mbajtur me datë 11 prill 2024, ka shqyrtuar kërkesën e datës 27 mars 2024, e parashtruar nga dekani i Fakultetit Juridik i Kolegjit AAB, lidhur me mundësimin e punës praktike të studentëve në gjykatat e Republikës së Kosovës.

KGJK-ja, pas analizimit të kësaj kërkesë si dhe legjislacionit në fuqi, e ka vlerësuar si të arsyeshme që të autorizoj kryetarët e gjykatave për nënshkrimin e marrëveshjeve me institucionet e arsimit lidhur me angazhimin e studentëve për punë praktike në gjykatat e Republikës së Kosovës, ngase të njëjtit janë përgjegjës për administrimin ditor të gjykatave.

Poashtu, KGJK ka vlerësuar se angazhimi dhe sistemimi i këtyre studentëve do të realizohej përmes komunikimit të ndërsjellët në mes gjykatave dhe institucioneve arsimore me ç' rast do të parashiheshin edhe modalitetet dhe specifikat lidhur me këtë çështje.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Albert ZOGAJ

Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës



Kopje e vendimit i dërgohet:

- Kryetarëve të gjykatave;
- Sekretariatit të KGJK-së, si dhe
- Arkivit.